7. “Shteti kërkues” nënkupton Shtetin (Republikën e Maqedonisë ose Republikën e Kosovës) që paraqet kërkesën për ripranim, në pajtim me nenin 5 ose kërkesën për kalim transit në pajtim me nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje;
8. “Shteti që i kërkohet” nënkupton shtetin (Republikën e Maqedonisë ose Republikën e Kosovës) të cilit i bëhet kërkesa për ripranim, në pajtim me nenin 5 ose kërkesa për kalim transit në pajtim me nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje;
9. “Autoritet kompetent” nënkupton çdo autoritet shtetëror të Republikës së Maqedonisë ose Republikës së Kosovës, i cili ngarkohet me detyrën e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, në pajtim me nenin 17, paragrafi (1) pika.a) të tij:
10. “Transit” nënkupton kalimin e një shtetasit të shtetit të tretë ose të një personi pa shtetësi, nëpërmjet territorit të Shtetit që i kërkohet, përderisa udhëton nga Shteti Kërkues drejt vendit të destinacionit.

PJESA I DETYRIMET E RIPRANIMIT

Neni 2 Ripranimi i Shtetasve të Vet

1. Shtetit që i kërkohet, me kërkesë nga Shteti Kërkues dhe pa formalitete tjera, përveç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, do t'i ripranojë të gjithë personat të cilët nuk i plotësojnë ose nuk i plotësojnë më tej kushtet ligjore që janë në fuqi për hyrje, ose qëndrim të ligjshëm në territorin e Shtetit Kërkues, me kusht që është dëshmuar, ose në mënyrë të arsyeshme supozohet mbi bazën e dëshmive në shikim të pare (*prima facie*), se ata janë shtetas të Shtetit që i kërkohet.
2. Shtetit që i kërkohet do t'i ripranojë në të njëjtën kohë, bashkëshortët si dhe fëmijët e mitur të pamartuar, të personave të përcaktuar në paragrin 1 të këtij Neni, të cilët posedojnë

shtetësinë e Shtetit që i kërkohet, përveç nëse ata kanë të drejtë të pavarur të qëndrimit në territorin e Shtetit kërkues.

3. Shteti që i kërkohet do t'i ripranojë personat të cilët janë liruar nga shtetësia e Shtetit që i kërkohet, pas hyrjes në territorin e Shtetit kërkues, përveç nëse këtyre personave nuk u është garantuar së paku natyralizimi nga ana e organeve kompetente të Shtetit kërkues.
4. Pasi që Shteti që i kërkohet i jep përgjigje pozitive kërkësës për ripranim, misioni diplomatik apo konsullor kompetent i Shtetit që i kërkohet, menjëherë por jo më gjatë se 3 ditë pune duhet të lëshojë dokumentin e udhëtimit të nevojshëm për kthimin e personit që duhet të ripranohet me afat të vlefshmërisë prej 30 ditëve. Nëse për shkak të arsyeve ligjore apo faktike personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda afatit të vlefshmërisë të dokumentit të udhëtimit, i cili i është lëshuar fillimisht, misioni diplomatik apo konsullor kompetent i Shtetit që i kërkohet duhet të lëshojë, pa ndonjë vonesë, dokumentin e ri të udhëtimit me të njëtin afat të vlefshmërisë;
5. Në rast se personi i cili duhet të ripranohet, posedon shtetësi të një shteti të tretë, përveç shtetësisë se Shtetit që i kërkohet, Shteti kërkues duhet të marrë parasysh dëshirën e personit që duhet të ripranohet për shtetin të cilin ai/ajo e ka zgjedhur. Shpenzimet e mundshme shtese për kthim në vendin e tretë do te mbulohen nga personi që do të ripranohet.

Neni 3

Ripranimi i Shtetasve të Vendeve të Treta dhe Personave pa Shtetësi

1. Shtetit që i kërkohet do të ripranojë, me kërkësë të Shtetit kërkues dhe pa formalitetë të tjera, përveç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi të cilët nuk përbushin, ose nuk përbushin më tej kushtet që janë në fuqi, për hyrje, ose qëndrim të ligjshëm në territorin e Shtetit kërkues, me kusht që të jetë dëshmuar ose mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme mbi bazë te dëshmisë se ofruar në shikim të pare (*prima facie*), se personat e tillë:
 - (a) posedojnë, ose në kohën e hyrjes së tyre kanë poseduar një vizë të vlefshme ose leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente të Shtetit që i kërkohet; ose
 - (b) në mënyrë të paligjshme kanë hyrë në territorin e Shtetit kërkues drejtpërdrejt përmes ajrit ose nga toka, pasi që kanë qëndruar ose kaluar transit në territorin e Shtetit që i kërkohet; ose;
 - (c) janë bashkëshortë të personave të përcaktuar në Nenin 2, paragrafi 1, të cilët

posedojnë shtetësi tjetër, me kusht që ata kanë të drejtë të hyjnë dhe qëndrojnë ose nga autoritetet kompetente të Shtetit që i kërkohet marrin të drejtën të hyjnë dhe qëndrojnë, në territorin e Shtetit që i kërkohet; ose

(d) janë fëmijë të mitur të pamartuar të personave të përcaktuar në Nenin 2, paragrafi 1, pavarësisht vendit të tyre të lindjes, përveç nëse ata kanë të drejtë të pavarur të qëndrojnë në territorin e Shtetit kërkues.

2. Detyrimi i ripranimit, nga paragrin 1, i këtij neni, nuk do të zbatohet nëse:

(a) Shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi ka qenë në transit ajror përmes Aeroportit ndërkombëtar të Shtetit që i kërkohet;

(b) Shteti kërkues i ka lëshuar shtetasit të shtetit të tretë ose personit pa shtetësi një vizë ose leje qëndrim, para ose pas hyrjes në territorin e saj, përveç nëse:

- ai person posedon vizë ose leje qëndrim, të lëshuar nga Shteti që i kërkohet, e cila ka periudhë më të gjatë të vlefshmërisë; ose
- viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga Shteti kërkues është marrë duke përdorur dokumente të ndryshuara ose falsifikuara, ose duke dhënë deklarata të rrejshme; ose
- ai person nuk përbushë disa nga kushtet e përcaktuara për dhënien e vizës.

3. Pasi që Shteti që i kërkohet ka dhënë përgjigje pozitive për kérkesën e bërrë për ripranim, Shteti kërkues (kur është e nevojshme) ia lëshon dokumentin e udhëtimit për kthim personit, të cilit i është pranuar ripranimi.

PJESA II PROCEDURA E RIPRANIMIT

Neni 4 Parimet

1. Kérkesa për ripranim nuk është e nevojshme, kur personi, i cili duhet të ripranohet posedon dokument të udhëtimit ose letërnjoftim të vlefshëm, dhe kur është e mundshme, personi posedon vizë të vlefshme ose leje qëndrim të vlefshëm në Shtetin që i kërkohet.
2. Përveç rasteve që përcaktohen në paragrin 1 i këtij Neni, çdo transferim i personit, i cili do të ripranohet, duke u bazuar në njërin prej detyrimeve, që përcaktohen në Nenin 2 dhe 3, kërkon gjithashtu dërgimin e kérkesës për ripranim tek organi kompetent të Shtetit që i kërkohet.

Neni 5
Kërkesa për Ripranim

1. Kërkesa për ripranim duhet të dorëzohet me shkrim drejtpërdrejt nga autoriteti kompetent i Shtetit kërkues tek autoriteti kompetent i Shtetit që i kërkohet përmes rrugëve të sigurta të komunikimit.
2. Përgjigja në kërkesën për ripranim duhet të dorëzohet në formë të shkuar drejtpërdrejt nga autoriteti kompetent i Shtetit që i kërkohet tek autoriteti kompetent i Shtetit kërkues përmes rrugëve të sigurta të komunikimit.
3. Kërkesa për ripranim duhet t'i përbaje informatat në vijim:
 - (a) të dhënat, e personit që duhet të ripranohet deri në masën që është e mundshme, (p.sh. emri, mbiemri, data dhe vendi i lindjes dhe vendbanimi i fundit, të dhëna mbi prindërit) dhe kur është e nevojshme të dhënat e fëmijëve të mitur të pamartuar dhe/ose bashkëshortëve;
 - (b) Shënimet e dhëna të dokumenteve me të cilat dëshmohen ose evidentohen me shikim të parë (*prima facie*) *kushtet për ripranim*;
 - (c) fotografia e personit që do të ripranohet;
4. Forma e përbashkët që do të përdoret për kërkesat për ripranim është e përcaktuar në shtojcën 5 të Protokollit për Zbatim.

Neni 6
Dëshmia e Shtetësisë

1. Dëshmia e shtetësisë sipas Nenit 2, paragrafi 1 të kësaj Marrëveshje mund të sigurohet në veçanti me çfarëdo lloj dokumenti të vlefshëm të përcaktuar në Shtojcën 1 të Protokollit për zbatim. Nëse dokumentet e tillë paraqiten, Shteti kërkues dhe Shteti që i kërkohet duhet së bashku të njojin shtetësinë, pa pasur nevojë për të bërë hetime të mëtejme. Dëshmia e shtetësisë nuk mund të sigurohet përmes dokumenteve të falsifikuara.
2. Dëshmia në shikim të parë (*prima facie*) e shtetësisë, sipas Nenit 2, paragrafi 1 i kësaj Marrëveshjeje, mund të merret me dokumentet e renditura në Shtojcën 2 të Protokollit për zbatim, edhe nëse vlefshmëria e tyre ka skaduar. Në rast se dokumentet e tillë paraqiten, Shteti kërkues dhe Shteti që i kërkohet duhet të supozojnë se supozimi i shtetësisë është

i bazuar, përveç nëse ata mund ta dëshmojnë të kundërtën. Dëshmia në shikim të parë (*prima facie*) nuk mund të sigurohet përmes dokumenteve të falsifikuara.

3. Në rast se asnjëri dokument i përcaktuar në Shtojcën 1 dhe 2 të Protokollit për zbatim nuk mund të paraqitet, misionet kompetente diplomatike dhe konsullore të Shtetit që i kërkohet, me kërkesë të autoriteteve kompetente të Shtetit kërkues duhet të organizojnë një intervistë me personin i cili duhet të ripranohet pa ndonjë vonesë të pa nevojshme, për shkak të marrjes së informatave për shtetësinë e tij/saj, me se largu brenda pesë (5) ditëve të punës nga data e dorëzimit të kërkesës.
4. Ekspertët mund të caktohen, kur nevojitet, të bëhet sigurimi i informatave shtesë të shtetësisë së personave që duhet të ripranojen.

Neni 7

Dëshmia e Shtetasve të Vendeve të Treta dhe e Personave pa Shtetësi

1. Dëshmia e kushteve për ripranim për shtetasit e vendeve të treta dhe personave pa shtetësi, të përcaktuara në Nenin 3, paragrafi 1 janë dhënë në mënyrë specifike nga provat e përcaktuara në Shtojcën 3 të Protokollit për Zbatim, ato nuk mund të sigurohen me dokumente të falsifikuara.
2. Dëshmia në shikim të parë (*prima facie*) për kushtet e ripranimit të shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi, të përcaktuara në Nenin 3, paragrafi 1, sigurohen në veçanti me dëshmitë e përcaktuara ne Shtojcën 4 të Protokollit për zbatim; ato nuk mund të sigurohen me dokumente të falsifikuara. Kur paraqiten dëshmitë e tillë *prima facie*, Shteti kërkues dhe Shtetit që i kërkohet duhet të pranojnë që kushtet janë provuar, përveç nëse ata mund të dëshmojnë të kundërtën.
3. Paligjshmëria e hyrjes ose qëndrimit do të përcaktohet nga dokumentet e udhëtimit të personave në fjalë, në të cilat viza e nevojshme ose leja tjetër e qëndrimit në territorin e Shtetit kërkues mungojnë.

Neni 8

Afatet Kohore

1. Kërkesa për ripranim duhet të dorëzohet tek autoriteti kompetent i Shtetit që i kërkohet brenda maksimum një (1) viti pasi që autoriteti kompetent i Shtetit kërkues ka marrë informacionin që shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi nuk i përmbushë ose nuk i përmbushë më tej kushtet që janë në fuqi për hyrje ose qëndrim të ligjshëm. Kur ekzistojnë pengesa ligjore ose faktike që kërkesa të dorëzohet me kohë, afati kohor duhet

të zgjatet me kërkesë të Shtetit kërkues, por vetëm deri sa pengesat të pushojnë së ekzistuari.

2. Në të gjitha rastet, përgjigja për kërkesën për ripranim duhet të kthehet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike. Ky afat kohor fillon nga data e pranimit të kërkesës për ripranim. Në rast se përgjigja nuk dërgohet brenda afatit kohor të caktuar, kërkesa konsiderohet si e pranuar. Arsyet për ndonjë refuzim të mundshëm duhet të jepen me shkrim.
3. Kur ekzistojnë pengesa ligjore ose faktike për tu kthyer përgjigja brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike për kërkesën e bërë, ky afat kohor, pas shqyrtimit të duhur të kërkesës, mund të zgjatet me se shumti deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike.
4. Pasi të jepet pëlqimi, ose kur është e përshtatshme, pas kalimit të afatit kohorë të përcaktuar në paragrin 2 dhe 3 të këtij Neni, personi në fjalë do të ripranohet brenda tre (3) muajve. Me kërkesë të Shtetit Kërkues, ky afat kohor mund të zgjatet për kohën që nevojitet për tu marrë me pengesat ligjore ose praktike.

Neni 9 **Modalitetet e Transferimit dhe Mënyra e Transportit**

1. Pas marrjes së miratimit për ripranim të personit ose në rastet kur nuk ka nevojë për dorëzim të kërkesës për ripranim, në pajtim me Nenin 4, parografi 1, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese në fjalë duhet të bien dakord paraprakisht dhe duhet ta njoftojnë njëra tjetrën me shkrim për datën e transferimit, pikën hyrëse, shoqërimet e mundshme si dhe për informatat tjera që janë të rëndësishme për transferim.
2. Për aq sa është e mundur dhe nëse është e nevojshme, njoftimet me shkrim të përcaktuara në paragrin 1 të këtij Neni, duhet të përbajnë edhe informatat në vijim;
 - a) deklaratën në të cilën përcaktohet që personi i cili duhet të kthehet, mund t'i nevojitet ndihma apo përkujdesja, në rast se kjo është në interes të personit në fjalë;
 - b) çfarëdo masë tjetër mbrojtëse ose e sigurisë, e cila mund të jetë e nevojshme në rastin e kthimit individual ose informatat në lidhje me shëndetin e personit, nëse kjo është në interes të personit në fjalë.
3. Transportimi mund të bëhet përmes ajrit ose tokës. Kthimi nëpërmjet rrugës ajrore nuk do të ketë kufizime për përdorimin e transportuesve vendorë të Palëve Kontraktuese dhe mund të realizohet duke përdorur fluturime të planifikuara ose charter.

Neni 10
Ripranimi Gabimisht

1. Shteti kërkues duhet ta kthejë çdo person të ripranuar nga Shteti që i kërkohet nëse brenda periudhës prej gjashtë (6) muajve pas transferimit të personit konstatohet se kushtet e përcaktuara në Nenin 2 dhe 3 të kësaj Marrëveshje, nuk janë përbushur në kohën e transferimit.
2. Në rastet e tilla, dispozitat procedurale të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen përshtatshmërisht "mutatis mutandis" dhe do të sigurohen të gjitha informatat në dispozicion që lidhen me identitetin e vërtetë dhe shtetësinë e personit që duhet të kthehet prapa.

PJESA III
OPERACIONET E TRANSITIT

Neni 11
Parimet

1. Palët kontraktuese duhet të kufizojnë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi në rastet kur personat e tillë nuk mund të kthehen drejtpërdrejt në shtetin e destinuar.
2. Shtetit që i kërkohet do ta lejojë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi, nëse Shteti kërkues e kërkon një gjë të tillë, nëse udhëtojnë me tutje transit në shtetet e tjera dhe nëse sigurohet ripranimi nga shteti i destinuar.
3. Palët kontraktuese mund të refuzojnë kalimin transit:
 - (a) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi i ekspozohet rezikut të vërtetë i të qenit subjekt i torturës apo trajtimit ç'njerezor apo degradues apo ndëshkimit apo dënimit me vdekje apo i persekutimit për shkak të racës së tij, fesë, shtetësisë, pjesëmarrjes në grupe shoqërore të caktuara apo bindjeve politike në shtetin e destinuar ose në ndonjë shtet tjetër të transitit; ose
 - (b) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi është subjekt i sanksioneve penale në Shtetin që i kërkohet apo në ndonjë shtet tjetër të transitit; ose
 - (c) për arsyet e shëndetit publik, sigurisë së brendshme, rendit publik ose interesave të tjera kombëtare të Shtetit që i kërkohet.

- Palët kontraktuese mund të revokojnë çdo leje të lëshuar nëse rrethanat e përcaktuara në paragrin 3 lindin më vonë ose dalin në pah, të cilat pengojnë operacionin e transitit, apo nëse gjatë udhëtit të mëtutjeshëm në vendet e mundshme të transitit apo ripranimi nga shteti i destinacionit nuk është më i siguruar. Në këtë rast, Shteti kërkues duhet ta kthejë shtetasin e vendit të tretë ose personin pa shtetësi pa vonesë, në rast se kjo është nevojshme.

Neni 12 **Procedura e Transitit**

- Kërkesa për operacione transite duhet të dorëzohet drejtpërdrejt nga autoriteti kompetent i Shtetit kërkues tek autoriteti kompetent i Shtetit që i kërkohet, nëpërmjet kanaleve të sigurta të komunikimit;
- Përgjigja në kërkesën për transit duhet të dorëzohet drejtpërdrejt nga autoriteti kompetent i Shtetit që i kërkohet tek autoriteti kompetent i Shtetit kërkues, nëpërmjet kanaleve të sigurta të komunikimit.
- Kërkesa me shkrim për operacionet transit duhet të dorëzohet drejtpërdrejt nga autoriteti kompetent i Shtetit kërkues tek autoriteti kompetent i Shtetit që i kërkohet, dhe duhet t'i përmbajë informatat në vijim:
 - Ilojin e transitit (nëpërmjet ajrit apo tokës), shtetet e tjera të mundshme ku do të kalohet transit, si dhe destinacioni final i synuar;
 - deri në nivelin që është i mundshëm, të dhënat e personit në fjalë (p.sh. emri, mbiemri, mbiemri i vajzërisë, emrat e tjerë të përdorur/ me të cilat njihet apo pseudonimet, data e lindjes, gjinia dhe - kur është e mundshme - vendi i lindjes, shtetësia, gjuha, Iloji dhe numri i dokumentit të udhëtit);
 - pika hyrëse e paraparë, koha e transferit si dhe detajet e përcjelljes, nëse ka;
 - një deklaratë se nga pikëpamja e Shtetit kërkues, kushtet në pajtim me Nenin 11, paragrafi (2) janë plotësuar, dhe se nuk ka arsyet e njohura për refuzim, sipas Nenit 11, paragrafi (3).

Forma përbashkët që do përdoret për kërkesat për transit, është bashkëngjitur si Shtojcë 6 e Protokollit për Zbatim.

4. Pala kontraktuese që i kërkohet, në afat prej pesë (5) ditëve kalendarike dhe në formë të shkruar duhet ta njofton Shtetin kërkues për ripranimin, duke e konfirmuar pikën hyrëse si dhe kohën e paraparë për ripranim ose duhet të informojë për refuzim të ripranimit, si dhe për arsyet e refuzimi të tillë.
5. Nëse operacioni transit do të realizohet nëpërmjet ajrit, personi i cili duhet të ripranohet si dhe përcjellja eventuale – brenda kornizës së kufizimeve të detyrimeve ndërkombëtare të Shtetit që i kërkohet – do të jenë të liruar nga lëshimi i vizës transite të aeroportit.
6. Autoritetet kompetente të Shtetit që i kërkohet duhet që, në bazë të konsultimeve të përbashkëta, të asistojnë në operacionet transite, në veçanti përmes vëzhgimit të personave në fjalë, si dhe sigurimin e pajisjeve të përshtatshme për këtë qëllim.

Pjesa IV SHPENZIMET

Neni 13 Shpenzimet e Transportit dhe e Transitit

Pa paragjykuar të drejtën e autoriteteve kompetente që t'i rikthejnë shpenzimet që lidhen me ripranimin e personit që duhet të ripranohet ose palëve të treta, shpenzimet e bëra për dokumentet e udhëtimit dhe të transportit, që dalin në lidhje me ripranimin, ripranimin e gabuar, si dhe operacionet transite, sipas kësaj marrëveshje, deri në kufirin e shtetit të destinacionit final, do të mbulohen nga Shteti kërkues.

PJESA V MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KLAUZOLA E PAPREKSHMËRISË

Neni 14 Mbrojta e të Dhënavë

Dërgimi i të dhënavë personale do të bëhet vetëm nëse komunikimi i tillë do të jetë i nevojshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, sic mund të jetë rasti. Përpunimi dhe trajtimi i të dhënavë personale në një rast të veçantë do t'i nënshtrohet legjislacionit kombëtar të Shtetit kërkues dhe Shteti që i kërkohet.

Në veçanti, do të zbatohen parimet në vijim:

- (a) të dhënat personale duhet të përpunojen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- (b) të dhënat personale duhet të mblidhen për qëllime të specifikuara, të sakta dhe legjitime,

për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe pa procedim të mëtejshmë as nga autoriteti dërgues, as nga autoriteti pranues që nuk është në përputhje me atë qëllim.

(c) të dhënat personale duhet të janë adekuate, relevante dhe që nuk e tejkalojnë qëllimin përfshirë cilën ato janë mbledhur dhe/ apo proceduar më tutje, në veçanti, të dhënat personale të komunikuara mund të janë vetëm si në vijim:

- detajet e personit që do të transferohet (p.sh. emrat e dhënë, mbiemrat, mbiemrat e vajzërisë, emrat e tjerë të përdorur në bazë të të cilave njihet personi apo pseudonimet, data e lindjes, gjinia dhe kur është e mundshme vendi i lindjes, shtetësia, gjuha, pasaporta, letërnjoftimi apo patentë shoferi (numri, vlefshmëria, data e lëshimit, autoriteti që e ka lëshuar, vendi i lëshimit).
 - ndalesat dhe itineraret,
 - informata të tjera që nevojiten për identifikimin e personit që do të transferohet apo informatat që nevojiten për shqyrtimin e kushteve të ripranimit në përputhje me këtë Marrëveshje.

(d) të dhënat personale duhet të janë të sakta dhe kur është e nevojshme, duhet të përditësohen;

(e) të dhënat personale duhet të mbahen në formën e cila lejon identifikimin e subjekteve të të dhënavë, por jo më shumë se sa kjo është e nevojshme për qëllimin përfshirë cilin këto të dhëna janë mbledhur ose për të cilin janë procesuar më tutje;

(f) tē dy autoritetet, si ai i pranimit dhe ai dorëzimit, duhet tē ndërmarrin çdo hap tē arsyeshëm që tē sigurojnë sa më shumë që tē jetë e mundur korrigimin e duhur, fshirjen apo bllokimin e tē dhënave personale, kur përpunimi i tyre nuk përputhet me dispozitat e këtij Neni, në veçanti kur këto tē dhëna, nuk janë adekuate, relevante, tē sakta apo ato janë tē tepërtë në lidhje me qëllimet e përpunimit apo procesimit. Kjo gjithashtu përfshin njoftimin e palës tjetër pér çdo korrigim, fshirje apo bllokim;

(g) me dorëzimin e kërkesës, autoriteti pranues duhet ta informon autoritetin dorëzues për përdorimin e të dhënave të dërguara si dhe me rezultat e marra;

(h) të dhënat personale mund tu komunikohen vetëm autoriteteve kompetente. Komunikimi i mëtejshmë tek organet tjera kërkon pëlqimin e autoritetit të dërgimit;

(i) autoritetet e dërgimit dhe ato të pranimit janë të obliguar që ta hartojnë një formë të shkruar të verifikimit të transferimit dhe të pranimit të të dhënave personale.

Neni 15
Klauzola e Paprekshmërisë

1. Kjo Marrëveshje nuk përjashton të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e secilës Palë Kontraktuese që dalin nga e drejta ndërkombëtare apo Konventat, direkt ose indirekt, dhe në veçanti si në vijim:
 - Konventa e datës 28 korrik 1951 mbi statusin e refugiatëve e ndryshuar me Protokollin e datës 31 Janar 1967 mbi statusin e refugiatëve;
 - Konventat ndërkombëtare që përcaktojnë shtetin përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të parashtruara për azil;
 - Konventën Evropiane të datës 4 nëntor 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
 - Konventën e datës 10 dhjetor 1984 kundër Torturës dhe Trajtimeve ose dënimive tjetra Mizore, Çnjerëzor ose Degraduese;
 - Konventat ndërkombëtare për ekstradimin dhe kalimin transit;
 - Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe për ripranimin e shtetasve të huaj.
2. Asnjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të të interpretohet në një mënyrë që do të parandalonte ripranimin e personave në pajtueshmëri me marrëveshjet tjetra formale apo joformale.

PJESA VI
ZBATIMI

Neni 16
Bashkëpunimi dhe Takimet e Ekspertëve

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do t'i japid njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellët për zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Secila Palë Kontraktuese mund të kërkojë thirrjen e takimeve të ekspertëve të të dyja Palëve Kontraktuese për sqarimin e çfarëdo çështjeje të mundshme që dalin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

3. Palët Kontraktuese do të zgjidhin pengesat që kanë të bëjnë me zbatimin kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 17
Protokolli për Zbatim

1. Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës do të përfundojë Protokollin për Zbatim i cili do të përcaktoj rregullat për:
 - (a) përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe pikat e kalimit kufitar;
 - (b) kushtet për kthimet me përcjellje, përfshirë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi me përcjellje;
 - (c) listën e evidencës;
 - (d) formën e përbashkët të kërkesave për ripranim dhe transit.

PJESA VII
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE


Neni 18
Hyrja në Fuqi, Kohëzgjatja, Ndryshimi, Pezullimi dhe Përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe do të miratohet/ ratifikohet, në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve Kontraktuese.
2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me të cilin Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën se janë përfunduar procedurat e brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.
3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe të plotësohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve Kontraktuese. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshjeje do të hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij Neni.

4. Çdo Palë Kontraktuese, duke njofuar zyrtarisht Palët e tjera Kontraktuese mund, tërësisht ose pjesërisht, përkohësisht të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, në raport me shtetasit e vendeve të treta dhe personat pa shtetësi për arsyen e sigurisë, mbrojtjes së rendit publik apo të shëndetit publik. Pezullimi i tillë do të hyjë në fuqi në ditën e dytë pas ditës së njoftimit.
5. Secila Palë Kontraktuese mund ta përfundoj këtë Marrëveshje duke njofuar zyrtarisht shtetin tjetër përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari pas kalimit të afatit prej tre (3) muajve nga data e njoftimit të tillë.


E bërrë në Shkup, Maqedoni më 4.12.2017 në dy kopje origjinale, secila prej tyre në gjuhën Maqedonase, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës (në gjuhën Shqipe dhe Serbe) dhe në gjuhën Angleze. Në rast të mos përputhjes në interpretimin e kësaj Marrëveshje, versioni në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.

Për
Qeverinë e
Republikës së Kosovës



Flamur Sefaj
Ministër i Ministrisë së Punëve të
Brendshme

Për
Qeverinë e
Republikës së Maqedonisë



Oliver Spasovski
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i
Ministrisë së Punëve të Brendshme